



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 901 , datë 11.11.2015

P Ë R

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10253, DATË 11.3.2010,
“PËR GJUETINË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I MJEDISIT

LEFTER KOKA

NR.PROT.3185/5
DATE 12.11.2015

KUVENDIT
MINISTRISË SE MJEDISIT

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A handwritten signature in black ink, reading "Engjëll AGAÇI", is written over a blue circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHQIPËRISË" at the top, "KESHILLI I MINISTRISË SE MJEDISIT" at the bottom, and a central emblem of the Albanian coat of arms.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2015

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10253,
DATE 11.3.2010, “PËR GJUETINË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura, zonat “Ramsar” dhe zonat “Rezervë e Biosferës”.”.

Neni 2

Në nenin 16 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “ç”, të pikës 1, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) zbulohet në të prania e llojeve tepër të rrezikuara në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare apo me rëndësi të madhe kombëtare dhe ndërkombëtare.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Statusi për zonat e gjuetisë rishikohet nga ministria çdo 5 vjet.”.

Neni 3

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Këshilli Konsultativ për Faunën e Egër dhe Gjuetinë

1. Pranë Ministrisë së Mjedisit ngrihet Këshilli Konsultativ për Faunën e Egër dhe Gjuetinë, si organ këshillimor, i cili ndihmon dhe këshillon ministrin në zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve të tij nënligjore. Këshilli Konsultativ për Faunën e Egër dhe Gjuetinë drejtohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për gjuetinë dhe ka në përbërjen e tij përfaqësues nga ministria, ministri të linjës, federatat dhe shoqatat e gjuetarëve, universitetet, institucionet kërkimore - shkencore, organizatat jofitimprurëse mjedisore.
2. Këshilli Konsultativ kryen funksionet e mëposhtme:
 - a) Kontribuon në hartimin e planeve e të programeve për zhvillimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e faunës së egër, objekt gjuetie.
 - b) Kontribuon në përcaktimin, kohëzgjatjen e sezonit të gjuetisë, listës së llojeve, objekt gjuetie, dhe kuotave të lejuara të gjuetisë.
 - c) Kontribuon në propozimin dhe hartimin e projekteve për zhvillimin e faunës së egër, objekt gjuetie, për zonat e gjuetisë, si dhe për ditët e lejuara për gjueti.
 - ç) Kontribuon në hartimin e kurikulave dhe programit të trajnimit të kursantëve për t'u pajisur me të drejtën për ushtrimin e aktivitetit të gjuetisë.
3. Përbërja dhe funksionimi i Këshillit Konsultativ për Faunën e Egër dhe Gjuetinë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë.”.

Neni 4

Pika 7, e nenit 24, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Deri në miratimin e planeve 10-vjeçare, menaxhimi i zonave të gjuetisë bëhet duke u mbështetur në planin vjetor të përdorimit të zonës së gjuetisë, që në këtë rast hartohet në përputhje me kërkesat e Programit Kombëtar të Zhvillimit të Gjuetisë.”.

Neni 5

Pas pikës 2, të nenit 26, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Deri në përzgjedhjen e menaxhuesit të zonës së gjuetisë sipas procedurës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që ky ligj i jep menaxhuesit delegohen te strukturat e varësisë së ministrisë me urdhër të ministrit.”.

Neni 6

Pas nenit 35 shtohet neni 35/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 35/1

Trajnimi i personave që do të ushtrojnë gjuetinë

1. Personat, që do të ushtrojnë gjueti, i nënshtrohen një kursi trajnimi përgatitor përpara kryerjes së testimit të gjuetarit. Kursi përgatitor organizohet nga OJF që kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë. Në përfundim të kursit të trajnimit, personat pajisen me certifikatë, sipas formatit të miratuar nga ministri.
2. Kurikulat e kursit të trajnimit përgatitor dhe kohëzgjatja e tij hartohen nga ministria në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ për Faunën e Egër dhe Gjuetinë dhe miratohen nga ministri.
3. Vlera tavan e tarifës që paguan personi për të zhvilluar kursin përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 7

Në pikën 2, të nenit 44, fjalët “... me propozimin e përbashkët të ministrit dhe të ministrit të Financave ...” zëvendësohen me “... me propozimin e ministrit ...”.

Neni 8

Në pikën 3, të nenit 47, fjalët "... armë gjahu të licencuar ..." zëvendësohen me "... armë gjahu me leje ...".

Neni 9

Pika 1, e nenit 48, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në përfundim të ditës së gjuetisë, gjuetari deklaron te menaxhuesi i zonës gjahun e vrarë, duke e treguar atë."

Neni 10

Pas shkronjës "e", të nenit 53, shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:

"ë) organizojnë kurse përgatitore për trajnimin e gjuetarëve."

Neni 11

Në nenin 59 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"1. Ushtrimi i gjuetisë pa u pajisur me leje gjuetie, me gjobë, në masën nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Ushtrimi i gjuetisë jashtë sezonit të gjuetisë apo jashtë orarit ditor në ditët e gjuetisë, qoftë edhe pa pasur gjah të vrarë ose të kapur, me gjobë, në masën nga 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë."

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Mosdeklarimi i gjahut të vrarë, me gjobë, në masën nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë."

Neni 12

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që në zbatim të nenit 3 të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që në zbatim të neneve 5 dhe 6 të nxjerrë aktin nëligjor në zbatim të këtij ligji.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

ILIR META

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10253, DATË 11.3.2010 “PËR GJUETINË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është që të përmirësojë ligjin aktual në disa aspekte dhe nene të caktuara të tij. Krahas disiplinimit që i bëri në tërësi veprimtarisë së gjuetisë, ligji dëshmoi dhe nevojën për disa ndërhyrje e përmirësime në nene apo procese të caktuara të tij.

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen me këtë akt lidhen me:

- përjashtimin e të gjitha zona të mbrojtura nga territoret e lejuara për ushtrimin e aktivitetit të gjuetisë, duke përfshirë edhe rezervat e biosferës;
- krijimin e Këshillit Konsultativ për Faunën e Egër dhe Gjuetinë;
- evidentimin dhe disiplinimin e tarifimit të ushtrimit të gjuetisë;

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj do t'i shërbejnë përmirësimit të punës në drejtimet e sipërpërmendura.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë 2013-2017 dhe me atë të Ministrisë së Mjedisit në fushën e natyrës e të biodiversitetit. Gjithashtu akti është i parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2015, PKIE, programin e 300-ditëshit të dytë të qeverisë shqiptare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Periudha e zbatimit të ligjit nr.10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, të ndryshuar, nga hyrja e tij në fuqi e deri në mars të vitit të kaluar kur filloi moratoriumi i gjuetisë, ka dëshmuar që ligji, krahas vendosjes së rregullave dhe kriterëve për mirërregullimin e veprimtarisë së gjuetisë, ka nevojë që të pasqyrojë dhe disa plotësime të kërkuara gjatë kësaj periudhe, sikurse dhe të ndryshojë dhe të përmirësohet në nene të caktuara të tij.

Një aspekt i rëndësishëm që synohet me këtë projektligj është përfshirja e sipërfaqeve të të gjitha zonave të mbrojtura sikurse dhe e zonave “Rezervë e Biosferës”, në arealin ku gjuetia nuk duhet të zhvillohet, gjë që do të sjellë sipërfaqe të tjera të qeta e të pangacmuara për rritjen e zhvillimin e faunës së egër.

Një tjetër risi që sjell ky ligj është ngritja pranë ministrisë e një strukture (këshill konsultativ) me funksione këshillimore. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje do të bëhet e mundur marrja dhe shprehja në mënyrë më të drejtpërdrejtë e mendimeve dhe përvojave që vijnë nga komunitetet e gjuetarëve, ministrisë e linjës, stafet akademike e shkencore etj, për çështje dhe aspekte të ndryshme të veprimtarisë së gjuetisë.

Për të zhvilluar një veprimtari gjuetie sa më efektive dhe për të aftësuar të gjithë ata që do të fillojnë të ushtrojnë këtë aktivitet, është parashikuar që të realizohet paraprakisht trajnimi i personave që do ta ushtrojnë gjuetinë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Sikurse u përmend më lart, ky akt del si një kërkesë për të përmirësuar më tej ligjin aktual “Për gjuetinë”, të ndryshuar dhe, me këtë rast, për të kompletuar më tej të gjithë kuadrin ligjor që lidhet me veprimtarinë e gjuetisë dhe mirëmenaxhimin e faunës së egër, objekt gjuetie. Ai është në përputhje me të gjithë legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*. Rregullat e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, që lidhen me mbrojtjen e faunës së egër e zhvillimin e gjuetisë, janë transpozuar tashmë dhe janë përfshirë në legjislacionin tonë për natyrën dhe biodiversitetin. Ndryshimet e propozuara nuk bien në kundërshtim me aktet e *acquis* të transpozuar dhe në fuqi.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, të ndryshuar”, synon përmirësimin e disa elementeve dhe problematikave të vërejtura nga implementimi i ligjit që synohet të amendohet.

Nenet 2, 4, 7, 9 dhe 10, të projektligjit, shprehin kryesisht përmirësime që duhet t’u bëhen neneve përkatëse të ligjit ekzistues.

Neni 1 synon të zgjerojë arealin ku fauna e egër mbrohet e konservohet, duke mos lejuar gjuetinë në të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura si edhe në sipërfaqet e zonave “Rezervë e Biosferës”.

Neni 3 ka parashikuar ngritjen e një Këshilli Konsultativ, me attribute të saktësuar konsultative në fushën e përgatitjes së dokumenteve strategjike dhe programeve të trajnimit të personave që dëshirojnë të ushtrojnë gjuetinë.

Neni 5 reflekton pamundësinë financiare që kemi pasur deri më tani si pasojë për të caktuar menaxhues për 254 zonat e gjuetisë, sikurse e kërkon neni 26 i ligjit. Për të zgjidhur këtë pamundësi të përkohshme me të cilën po përballët Ministria e Mjedisit, propozohet që pas pikës 2, të nenin 26 të ligjit në fuqi, të shtohet pika 3, e cila autorizon ministrin përgjegjës për gjuetinë të delegojë te strukturat e varësisë së ministrisë të drejtat dhe përgjegjësitë që i atribuohen menaxhuesit.

Në këtë pikë theksojmë një moment tepër të rëndësishëm në lidhje me frymën e ligjit sa i takon menaxhuesit të zonës së gjuetisë. Ligji në tërësinë e tij përshkohet nga qëllimi për një menaxhim efektiv dhe të pavarur të të

gjithë procesit të gjuetisë, që nga hartimi i planit të menaxhimit të një zone gjuetie e deri tek administrimi i vazhdueshëm i gjuetisë nëpërmjet menaxherëve si persona që ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë autonome nga strukturat publike, të cilët nga ana e tyre përzgjidhen me një procedurë konkrete ligjore konkurrimi publik. Kjo gjetje është bazuar në praktikën më të mirë të Bashkimit Evropian dhe përfshirja e menaxherit në legjislacionin shqiptar përbën një hap cilësor drejt zhvillimit të qëndrueshëm të faunës së ergër, objekt gjuetie, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nëpërmjet nenit 6 parashikohet që të futet koncepti dhe praktika e trajnimit paraprak të të gjithë atyre personave që duan të fillojnë aktivitetin e gjuetisë, gjë që do t'i aftësonte dhe do t'i pajiste ata me njohuri të plota rreth faunës së egër, objekt gjuetie, por dhe jo vetëm, dhe gjuetisë mbi të.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Mjedisit është institucioni kryesor zbatues i këtij akti, po për aspekte të veçanta të aktit, do të bashkëpunojë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Financave.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mjedisit. Gjatë hartimit drafti është konsultuar edhe me grupet e interesit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk do të ketë efekte shtesë financiare në buxhetin e shtetit, pasi implementimi i tij nuk do të kërkojë financime shtesë nga ky buxhet.

KËSHILLI I MINISTRAVE